

FINANCA

BULETINI MUJOR | QERSHOR 2025



MINISTRI MALAJ MERR PJESË NË MBLEDHJEN E KONSTITUENCËS SË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE

Ministri i Financave mori pjesë në Mbledhjen e Konstituencës së FMN dhe Grupit të BB, që u zhvillua në datat 26–27 Qershor 2025, në VAREZE të Italisë. Në këto takime u diskutuan zhvillimet më të fundit të dy institucioneve ndërkombëtare, ndërsa një vend të rëndësishëm në diskutimet mes pjesëmarrësve ishin zhvillimet e fundit gjeopolitike, sfidat që po kalojnë ekonomitë e vendeve të Europës dhe mënyrat për

kapërcimin e tyre. Ministri Malaj theksoi rëndësinë e vijimësisë së koordinimit midis vendeve dhe mbështetjes nëpërmjet dy institucioneve partnere. Ministri theksoi faktin se ekonomia shqiptare ka vijuar të rritet me ritme relativisht të larta e të qëndrueshme. “Në vitin 2024, PBB arriti në rreth 25 miliardë euro, me një rritje reale prej 4%, ndërsa financat publike vijuan trajektoren e tyre konsoliduese, ku borxhi publik shënoi nivelin më të ulët prej 54% të PBB-së”, tha z. Malaj. FMN dhe BB mbeten partnerë kyç në përparimin e agjendës së reformave për Shqipërinë.

LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ PREZANTOI NË KOMISIONIN PËR EKONOMINË DHE FINANCAT NDRYSHIMET NË BUXHETIN 2025

Ministri Petrit Malaj prezantoi në komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat aktin Normativ nr.6, datë 11.06.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025, të ndryshuar”. Hartimi i aktit u realizua pasi Ministria e Financave bëri një analizë të plotë të performancës 5-mujore të të ardhurave dhe shpenzimeve, nga e cila rezultoi se kishte nevojë për

ndërhyrje në Buxhetin 2025. “Duke pasur në konsideratë devijimet në ecurinë e investimeve nga planifikimi fillestar, lindi nevoja për një rishikim të parametrave buxhetorë, me qëllim harmonizimin e tyre me ecurinë reale, të zbatimit të buxhetit për vitin 2025”, tha z. Malaj. Ministri theksoi se ndryshimet buxhetore të parashikuara janë vetëm rialokime në zërat e shpenzimeve buxhetore, të cilat nuk kanë efekte te treguesit bazë makrofiskalë dhe ata buxhetorë, që do të thotë se të ardhurat, totali i shpenzimeve, deficitit dhe borxhi publik mbeten të pandryshuara.

LEXO MË SHUMË



GARANCIA SOVRANE 3 MILIARDË LEKË PËR SEKTORIN E BUJQËSISË, MINISTRIA E FINANCËVE ORGANIZON NJË TAKIM ME DREJTUESIT E BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË



Ministri i Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zhvilluan një takim të përbashkët me drejtuesit e bankave të nivelit të dytë dhe përfaqësuesit e Shoqatës së

Bankave për të diskutuar mbi aspektet teknike të zbatimit të Garancisë së re Sovrane për sektorin e bujqësisë. Garancia Sovrane me fond prej 3 miliardë lekësh ose 30 milionë euro është një instrument i cili do të vihet në shërbim të sektorit privat me qëllim lehtësimin e aksesit në financë për fermerët dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. Normat që parashikohen për këtë skemë do të jenë tejet të favorshme dhe me mbulim deri në 70% të principlalit të kredisë, shuma e së cilës nuk do të kalojë 25 milionë lekë për secilin prej subjekteve aplikuese. Kjo është Garancia e pestë Sovrane që qeveria shqiptare vë në dispozicion të sipërmarrjeve private, si një mundësi për likuiditet të shtuar, me shtetin si garantues.

LEXO MË SHUMË



PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS PARAPRAKE TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR–MAJ 2025

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar – Maj 2025 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 5 mujore të vitit 2025, arritën në rreth 305.92 miliardë lekë, një realizim në masën 100.2 % të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u mblodhën rreth 18.7 miliardë lekë më shumë ose 6.5 % më shumë. Në terma vjetorë, të ardhurat totale për 5 mujorin e vitit 2025 u realizuan në masën 40.4% të planit vjetor. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 5 mujore të vitit 2025, arritën në rreth 265.52 miliardë lekë me një realizim në masën 95.4% e planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ky zë ka rezultuar 12.1% më i lartë ose rreth 28.6 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 5 mujorin e vitit 2025 u realizuan në masën 32.2% e planit vjetor.

LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ TAKOHET ME AMBASADORIN E RI TË ITALISË NË SHQIPËRI

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, priti në një takim kortezie ambasadorin e ri të Italisë në Shqipëri, z. Marco Alberti. Gjatë këtij takimi, palët konstatuan marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve tona. Ministri Malaj shprehu vlerësimin se Italia është jo vetëm një

KONFERENCA E NIVELIT TË LARTË E DREJTORËVE TË PËRGJITHSHËM TË DOGANAVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR DHE SHTETEVE ANËTARE TË BE

Ministri i Financave mori pjesë në Konferencën e Dytë të Nivelit të Lartë të Drejtorëve të Përgjithshëm të Doganave të Ballkanit Perëndimor dhe

shteteve anëtare të BE-së “Partneriteti doganor për një Evropë të Lidhur –Thellimi i bashkëpunimit doganor CEFTA–BE për një lidhje të Pandërprerë”. Në fjalën e tij, Ministri Malaj theksoi rëndësinë e përmirësimit të efikasitetit doganor në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin European, që është një ambicie e përbashkët e

nga partnerët kryesorë strategjikë të Shqipërisë, por edhe një nga mbështetëset më të forta në rrugën drejt integritimit në Bashkimin European. Ministri Malaj dhe Ambasadori Alberti ndanë bashkërisht vullnetin e plotë për të forcuar më tej bashkëpunimin në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit tonë, përmes financimit të një sërë programeve.

LEXO MË SHUMË



MINISTRI I FINANCËVE TAKOHET ME MENAXHERIN E RI TË BANKËS BOTËRORE PËR SHQIPËRINË

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, priti në një takim Menaxherin e ri të Bankës Botërore për Shqipërinë, z. Massimiliano Paolucci. Z. Paolucci ka një përvojë të gjatë pune pranë Bankës Botërore, përmes drejtimit të rajoneve të ndryshme, së fundmi edhe në Kosovë. Gjatë këtij takimi, palët diskutuan mbi ecurinë e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Bankës

Botërore. Ministri Malaj shprehu angazhimin për të vijuar bashkëpunimin ndërinstitutional, sidomos sa i përket avancimit të projekteve aktuale me Bankën Botërore në disa sektorë prioritarë të ekonomisë së vendit, si dhe për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit në të ardhmen. Portofoli ynë me Bankën Botërore, përveç asistencës teknike, përfshin një sërë instrumentesh financiarë, ku ndër më të rëndësishmit është ai i mbështetjes buxhetore.

LEXO MË SHUMË



KUVENDI MIRATON AKTIN NORMATIV PËR NDRYSHIMIN E BUXHETIT 2025 DHE TRE PROJEKTLIGJE TË PROPOZUARA NGA MF

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancën plenare të datës 5 Qershor 2025 aktin normativ nr.3, datë 29.04.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”. Përmes këtij akti normativ është bërë i mundur financimi i pjesëmarrjes së qeverisë shqiptare në startup-in “Thinking Machines Lab”, me një fond prej 1 miliard lekësh. Gjatë fjalës së, Ministri Malaj theksoi se një

investim i tillë nuk duhet parë vetëm si një angazhim financiar, por si një mundësi strategjike për të ndërtuar të ardhmen teknologjike të Shqipërisë dhe për të pozicionuar vendin si një pikë referimi për inovacionin në rajon dhe më gjerë. Gjithashtu, Kuvendi miratoi tre nisma të tjera ligjore të propozuara nga Ministria e Financave. Një prej tyre është lidhet me pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit “Doganat”. Ky program është një nismë thelbësore e BE që synon të forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve doganore të shteteve anëtare dhe vendeve të tjera pjesëmarrëse, siç është rasti i Shqipërisë.

LEXO MË SHUMË